

# **RAPORTI VJETOR**

## **VITI AKADEMIK 2021-2022**

**Tirana Business University College**

**Tiranë, Shkurt 2023**

Raporti Vjetor për Vitin Akademik 2021-2022 i Tirana Business University College (TBU) është hartuar në përputhje me Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si edhe në përputhje me Udhëzimin Nr. 5, datë 19.02.2018 "Për përcaktimin e elementëve të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të Institucioneve të Arsimit të Lartë", i ndryshuar.

Renditja e materialeve në këtë raport ndjek plotësimin e kërkesave sipas, Udhëzimit të ministrisë të përmendura më lartë.

**Ky raport përmban:**

**A. Dokumentacionin e përgatitur nga Senati Akademik** (*i renditur sipas kërkesave të Udhëzimit të MASR*).

**B. Dokumentacionin e përgatitur nga Bordi i Administrimit** (*i renditur sipas kërkesave të Udhëzimit të MASR*).

**C. Anekse**

**Aneksi 1:** Lista e aktiviteteve ekstrakurrikulare në TBU

**Aneksi 2:** Staf i Akademik, ngarkesat dhe lëndët gjatë Vitit Akademik 2021- 2022

**Aneksi 3:** Dokumentacioni i shlyerjes së detyrimeve tatimore si dhe dokumentacioni për shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

**Aneksi 4:** Raporti i MASR për verifikimin e kapaciteteve pritëse për vitin 2021-2022



## **A. Dokumentacioni i përgatitur nga Senati Akademik**

**a) Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, mësim- nxënies, si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime, me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të IAL-së.**

Veprimtaritë akademike, shkencore dhe institucionale të TBU, gjatë vitit akademik 2021-22 u bazuan në Strategjinë e Zhvillimit 2018-24 dhe mbi atë të Kërkimit Shkencor viti 2018-24, në buxhetin afatmesëm për tre vitet akademike 2018-21, në buxhetin për vitin akademik 2021-22; në planin vjetor të objektivave të realizuara dhe veprimtarive për vitin akademik 2021-22.

Ky vit akademik, ashtu si dhe një pjesë e vitit të kaluar, përkoi me një situatë të vështirë të krijuar prej pandemisë së shkaktuar nga COVID 19, ku zhvillimi i mësimi u krye online, kjo bazuar në vendimet e urdhërimit e MASR. Por, pavarësisht situatës së krijuar në tërësinë e vet rezultoi se gjatë Vitit Akademik 2020-2021 në TBU, janë realizuar të gjitha objektivat e vendosura për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor dhe veprimtaritë e tjera të TBU.

*Më poshtë përmendim disa nga elementet më kryesore:*

### **1. Punësimi në profil i studentëve dhe përfshirja në sipërmarrje**

Objektivi i parë i TBU është punësimi në profil i studentëve, përpara diplomimit në programin bachelor, ndërsa për studentët master ngritja me të paktën një shkallë në karrierën profesionale. Për vitin 2021-22 objektivi fillestar ishte që treguesit në % të vitit 2020-21, të arriheshin dhe tejkaloheshin. Të dhënat tregojnë se objektivi u realizua me një sukses relativisht të kënaqshëm duke filluar dhe rikuperimin pas periudhës së vështirë të shkaktuar nga pandemia COVID 19 dhe shkurtimit të pozicioneve të punës në një pjesë të konsiderueshme të kompanive vendase dhe ndërkombëtare.

Rikuperimi nga këto dy efekte filloi të japë shenjat e para pozitive në verën 2020 por duhet thënë rikuperim më i fortë filloi pas përmbylljes së vitit akademik 2021.

Përqindja e punësimit në profil të studentëve të diplomuar të TBU-së për vitin akademik 2021-2022 është relativisht e lartë. Përfshirja në një fazë të hershme e studentëve në procese pune dhe praktike, si dhe angazhimi kryesisht në kompani të mëdha dhe të mesme i ndihmoi ata të jenë të qëndrueshëm me punësimin, ndonëse gjatë këtij viti largimet nga puna ishin të larta, si një nga mënyrat për të reduktuar kostot operative, për shkak të reduktimit të aktivitetit. Një përqindje e lartë e studentëve bachelor arrijnë të punësohen ende pa përfunduar studimet bachelor, ndërsa ata master të ngjiten një shkallë më lartë në karrierë. Përfshirja e studentit në procese pune dhe praktike në një fazë sa më të hershme ndihmohet nga Zyra e Karrierës dhe Çështjeve Studentore. Në ciklin e studimeve bachelor në vitin akademik 2021-22; u diplomuan 106 studentë (19 studentë në E Drejtë Biznesi), nga të cilët 15 studentë rezultojnë të punësuar në profil. Në ciklin e studimeve master në vitin akademik 2021-22; u diplomuan gjithësej 97 studentë, (17 studentë në E Drejtë Biznesi) nga të cilët rezultojnë të punësuar 78 e nga këto 75 në profil. Nga këto në profil mbi 50 prej tyre raportuan ngritje në përgjegjësi dhe/ose page.

Rezultatet e mësipërme janë rrjedhojë e një sërë veprimtarish (me karakter mësimor, shkencor, edukativ, zhvillues, etj.) të realizuara nga TBU, që sigurojnë një formim profesional të lartë të studentëve si kombinim i një procesi të harmonizuar teorik e praktik që zhvillohet në TBU duke filluar që në vitin e parë bachelor, por edhe rrjedhojë e cilësisë në rritje të studentëve të rinj vit pas viti.

Punësimi i studentëve të TBU, në shumicë përpara përfundimit të vitit të tretë mbështetet nga arritja e punësimit me pjesë të konsiderueshme të tyre në vitin e dytë dhe me një pjesë fillestare të rëndësishme që në vitin e parë.

TBU ka praktikuar një orar mësimor fleksibël dhe një kalendar akademik të përshtatshëm mësimor, i cili eviton përplasjen me orarin dhe kalendarin e praktikave ose kohës së punës me pagesë të studentëve që ndjekin studimet.

TBU ka hartuar kriteret e pranimit të studentëve të rinj për çdo program studimi, në funksion të sigurimit të cilësisë në pranim të kandidaëve të rinj, duke harmonizuar strukturën e pikëve, mesatare e shkollës së mesme me gadishmerinë për të pranar sfidën e shkollës; mësim-punë gjatë

periudhës së studimeve.

Përgjatë këtij viti akademik TBU ka vijuar të zgjerojë ndjeshëm rrjetin e bashkëpunimeve me kompani vendase dhe të huaja, me sistemin bankar, retail dhe zyra profesionale, në të cilat praktikohen dhe punësohen studentët tanë.

Gjatë vitit 2021-22, sipas planit vjetor institucional, u realizuan disa aktivitete ekstrakurrikulare të parashikuara lidhur me formimin sipërrmarës të studentëve. TBU ka angazhuar profesionistë të jashtëm dhe ekspertë të spikatur në fusha të ndryshme për të zhvilluar veprimtari extra-kurrikulare në fushat që përputhen me lëndët që zhvillohen.

## **2. Rruajtja e kapacitetit të plotë njëherazi duke rritur cilësinë e studentëve**

Ashtu sikurse parashikuar ne strategjinë e zhvillimit, numri i studenteve ka arritur kapacitetin e plotë që në vitin 2017-2018 dhe vijon të mbetet ne nivelet e rreth 500 studentë aktiv e që ndjekin studimet në kohë normale edhe për vitin akademik 2021-2022. Rritja numerike tashmë e konsoliduar prej tre vitesh akademike nuk ka cënuar cilësinë e studentëve dhe gjithashtu shkallën e arritjes së objektivave institucionale.

Totali i studentëve për vitin akademik 2021-22 në TBU ka qenë 474 studentë, ku 284 studentë ishin në ciklin e studimit bachelor dhe 190 studentë në ciklin master për të dy fakultetet, Fakultetin e Administrimit të Biznesit dhe Fakultetin e Drejtësisë.

Vlen të theksohet se e gjithë puna përgatitore për ruajtjen e këtij objektivit në vitin akademik 2021-2 është bërë përgjatë vitit akademik 2020-21.

Për vitin akademik 2021-2022, aktivitetet njohëse dhe prezantuese të TBU u bazuan në: i) konkurset kombëtare të përvitshme me gjimnazistët, kryesisht maturantë, “Sipërmarrësit e së Nesërmes” dhe “Juristët e së Nesërmes”; ii) ditët e informimit online; iii) opinionin pozitiv të studentëve dhe alumni tek kandidatët e rinj për studentë.

Numri i kuotave të pranimit për regjistrimet rishtaz në programet Bachelor në TBU është i njëjtë, si në vitin pararendës, ndërsa numri i aplikimeve nëpërmjet portalit të maturantit “Ualbania” ka një rënie, duke arritur në raportin aplikant për kuotë 4:1 nga 5:1 përpara një viti. Kjo rënie e

aplikimeve lidhet ngushtësisht: i) me krizën ekonomike të krijuar pos periudhës së COVID-19, ii) uljen e numrit të maturantëve/gjimnazistëve, të regjistruar në konkurset e përvitshme, si dhe iii) rënien e numrit total të regjistrimeve në arsimin e lartë. Në ndryshim nga viti akademik 2020-21, interesi për vijimin e studimeve master është më i lartë. Rritje kërkesë pati gjithashtu edhe për transferimin e studimeve në ciklin Bachelor, veçanërisht në Programin Administrim Biznesi.

Në regjistrimet në ciklin master, shifra e regjistrimeve për vitin akademik 2021-22 është shifër rekord krahasuar me vitet pararendëse (11% më tepër krahasuar me vitin akademik paraardhës), ndërsa numri i kërkesave tejkaloj me rreth 30% numrin e kuotave të planifikuara duke forcuar kështu konkurrencën në hyrje dhe cilësinë e studentëve të pranuar. Kujtojmë se për të tretin vit radhazi numri i kërkesave tejkaloj kuotat master në vitin pararendës.

Vlen të theksohet se TBU nuk bën shpenzime për reklama televizive dhe lloje të tjera të marketingut të kushtueshëm dhe e bazon zgjerimin e njohjes së shkollës, përmes kontakteve të drejtpërdrejta, konkurseve të përvitshme me maturantë (*sikurse e pasqyrojmë më sipër*) dhe në veçanti në rolin shumë të madh që luajnë vetë studentët e TBU në përhapjen e opinionit pozitiv për shkollën, bazuar në eksperiencën vetjake, dhe emocioneve të aplikantëve të rinj.

### **3. Përmirësime kurrikulare dhe aktivitete extra kurrikulare**

Për cdo vit akademik TBU ndërton një plan pune që përfshin përmirësime kurrikulare dhe aktivitete extra kurrikulare, që janë në shërbim të drejtpërdrejtë të formimit profesional të studentëve.

Objektiv i rëndësishëm për mësimdhënien dhe mësimnxënies ishte përmirësimi i kurikulave të programeve mësimore duke futur lëndë të reja por edhe duke bërë ndryshime në strukturën e lëndëve që ofrohen për cdo vit, kjo në shërbim të përshtatjes sa më të mirë së lëndëve me profilin e studimeve dhe gjithashtu ofrimin për studentët me njohuri të dobishme për ti bërë më të aftë në situata konkrete praktike.

Edhe për këtë vit akademik planet mesimore që u hartuan dhe u zbatuan ishin përshtatur në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “*Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë*“, i ndryshuar. Njesite baze përgjegjëse për programet e studimit përshtaten në mënyrë krijuese strukturën e secilit program në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 41, të përmendur më lart dhe mbi bazën e këtyre strukturave u hartuan dhe planet mësimore

indikative. Rregulloret e reja të të gjitha programeve të studimit të ofruara nga TBU, me strukturat e reja të përshtatura sipas VKM Nr. 41, ju njoftuan edhe MASR përpara fillimit të vitit akademik 2021-2022.

Gjithashtu më lart në këtë raport kemi përmendur edhe realizimin e një sërë aktiviteteve ekstrakurrikulare, të cilat i paraqesim në Aneksin 1.

#### **4. Përmirësimi i treguesve të mësimnxënies**

Ndërsa cilësia e studentëve të TBU konfirmohet në radhë të parë nga shkalla e punësimit të tyre, pra nga punëdhënësit të cilët, për shkaqe të kuptueshme, japin një vlerësim me objektiv se vetë TBU, në ndjekim gjithashtu me kujdes edhe ecurinë e mësimnxënies së studentëve tanë përmes disa parametrave ku më kryesori është rezultati në nota. Duhet thënë paraprakisht, ashtu sikurse përmendur edhe në fillim të këtij raporti, edhe pse mësimi është zhvilluar online gjatë gjithë vitit akademik, kjo nuk ka penguar në arritjen dhe ruajtjen e objektivave të vendosura për mësimnxënien. Kjo kuptohet është rezultat i angazhimit maksimal të të gjithë stafit akademik dhe të gjitha strukturave të TBU.

Objektiv i rëndësishëm për mësimdhënien dhe mësimnxënien ishte ruajtja e treguesve të mesatares dhe përmirësimi i tyre si në nivel bachelor edhe në atë master. Në programin bachelor në Administrim Biznesi, mesatarja ishte 8,13 në vitin 2021-2022, duke pësuar rritje nga një vit më parë. Një rritje kemi gjithashtu dhe për programin bachelor në E Drejtë Biznesi, ku mesatarja ishte 7.91 për vitin akademik 2020-2021 dhe u arrit 8.89 në vitin akademik 2021-22. Gjithashtu, për programet master vërehet një përmirësim i notës mesatare nga 8.47 në vitin akademik 2020-2021, në 8.70 në vitin akademik 2021-2022. Njësitë bazë të fakulteteve janë përgjegjësit kryesorë për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe arritjen e objektivave institucionale.

Për vitin akademik 2021-2022, është arritur objektivi i diplomimit me mesatarisht mbi 75% e studentëve, për programet bachelor në “Administrim Biznesi” dhe Bachelor në “E Drejtë Biznesi”, dhe mesatarisht me mbi 100% e studentëve të programeve master.

Njësitë bazë në nivel fakulteti, për secilin fakultet, kanë bërë një punë të mirë për mbështetjen e studentëve, sidomos gjatë përgatitjes së temave të diplomave, ku u vendos theksi në punime cilësore, në risi origjinale dhe të punuara nga vetë studentët nën monitorimin rigoroz të



udhëheqësve të tyre. Koordinimi i punës drejtuese dhe udhëheqëse “pedagog-student” për hartimin, drejtimin, finalizimin e temave të diplomave filloi në fillimin e vitit akademik. Këtë vit akademik, u aplikua për herë të katërt në TBU edhe provimi i formimit krahas diplomimit me temë diplome, në përputhje kjo me Ligjin 80/2015 dhe rregulloret e TBU.

## 5. Kërkimi shkencor

Për vitin akademik 2021-2022, objektivi i njësisë bazë të kolegjit universitar TBU dhe sidomos i Qendrës për Kërkime Ekonomike dhe Juridike ishte që TBU të aplikonte si institucion në projekte kombëtare, ndërkombëtare dhe projekte Erasmus+. Gjatë këtij viti Qendra ka qenë pjesë e aktivitetit (ëbënar) për përgatitjen e raportit të procesit të Smart Specialisation Strategy (S3) sipas metodologjisë (Literature review, Intervieës ëith stakeholders, Online focus group) së Joint Research Center (JRC) të Komisionit Europian: analizë cilësore dhe sasiore në lidhje me fushat ku Shqipëria mund të ketë një specializim smart sipas agendes së BE-së për anëtarësimin e vendit: <https://s3platform.jrc.ec.europa.eu/albania>.

Po gjatë këtij viti akademik, TBU rezultoi fitues dhe implementoi me sukses projektin Erasmus+.

**b. Informacion mbi bashkëpunime ndërinstitucionale dhe projekte ku merr pjesë IAL-ja, ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.**

TBU së bashku me disa universitete të tjera shqiptare dhe Universitetin Staffordshire nga Mbretëria e Bashkuar, TBU u bë fitues për herë të tretë në projektin Erasmus+KA1. Gjatë vitit akademik 2021-2022 u implementua shkëmbimi studentor dhe stafi akademik me Universitetin Staffordshire në Mbretërinë e Bashkuar dhe prej studentëve të cilët aplikuan për t’u bërë pjesë e këtij programi u për zgjidhen 4 fitues të cilët do të kryejnë një semestër në universitetin Staffordshire. Gjithashtu, 7 persona të stafit akademik u bënë pjesë të programit Erasmus + duke vizituar dhe shkëmbyer eksperiencën me stafin akademik në universitetin Staffordshire dhe duke sjellë me vete në Tirana Business University Colleague metodologji dhe menyrë të reja të zhvillimit të kurrikulave mësimore dhe mënyra novatore për zhvillimin e programeve përkatëse për rritur bashkëveprimin me studentët dhe për të përgatitur me risitë e tregut të punës në nivel

ndërkombëtar.

**c) Informacion mbi kërkimin shkencor në IAL ose në projekte ku merr pjesë si palë aktive, i cili përfshin:**

***i) Politikat e Kërkimit Shkencor***

Aktiviteti në fushën e kërkimit shkencor i TBU mbështetet dhe zhvillohet në përputhje me ligjin 80 / 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionët e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Senati i Universitetit i propozon për miratim Bordit të Administrimit Planin Strategjik të zhvillimit përfshi atë për kërkimin shkencor.

Njësi bazë për kërkimin shkencor janë departamentet të cilat janë të organizuara në grupe të përkohshme për qëllimin e përcaktimit të tematikave për kërkimin shkencor si edhe kryerjen e këtij kërkimi në bashkëpunim edhe me Qendrën për Kërkime Ekonomike dhe Juridike (QKSEJ). Departamentet përfshijnë shpesh edhe studentët, kryesisht studentët e ciklit të dytë të studimeve, për të bashkëpunuar për tematika të ndryshme të kërkimit shkencor.

Qëllimi i politikave të TBU është të sigurojë që kërkimi të jetë efektiv dhe të zhvillohet me standarde sa më të larta. Këto politika përfshijnë:

- Përfshirjen e TBU si institucion në kërkimin shkencor, të cilin e realizon me aplikime dhe pjesëmarrje në projekte.
- Zhvillimin e politikave shkencore të kërkimit shkencor në nivel pedagogësh dhe studentësh.
- Fuqizimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor çdo vit e në vazhdimësi.
- Ndërtimin e politikave të kërkimit shkencor mbi baza praktike, duke krijuar një urë lidhje midis univertitetit me bizneset, kompanitë dhe qendrat kërkimore dhe shkencore brenda dhe jashtë vendit.
- Krijimin e një data bazë për bizneset
- Bashkëveprimin me biznese që zhvillojnë aktivitet kërkimor shkencor.

- Barazi dhe akses për të gjithë stafin që dëshiron të bëhet pjesë e grupeve kërkimore të krijuara për këtë qëllim.
- Inkurajim individual për secilin anëtar të departamentëve për të avancuar më tej në fushën e tyre të kërkimit shkencor
- Krijimi i kushteve sa më të mira, në terma të ngarkesës mësimore, kapaciteteve fizike përfshi aksesin në librarinë elektronike EBSCO host, që të gjithë anëtarët e stafit të mund të bëjnë kërkim shkencor të pavarur.
- Inkurajimin e stafit akademik në hulumtime konkrete në dobi të komunitetit dhe institucioneve shtetërore.
- TBU promovon kërkimin shkencor aplikativ, ku stafi akademik mund të bëjë kërkim shkencor për biznese apo institucione të caktuara dhe gjithashtu ndihmon në gjetjen dhe lehtësimin e komunikimit midis kërkuesit dhe bizneseve apo institucioneve.
- TBU nxit dhe inkurajon stafin akademik që të prodhojë kërkim shkencor me cilësi të lartë dhe të kryer në përputhje me të gjitha obligimet dhe standardet etike.
- TBU nxit kërkuesit e rinj drejt risive që ofron kërkimi i mirfilltë shkencor.

## **ii) Të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien**

Kërkimi shkencor është një nga synimet kryesore të stafit akademik në TBU, për të vënë në shërbim të avancimit të njohurive në fushat specifike, zhvillimit kurrikular, dhe pse jo të ekonomisë dhe zhvillimit, kapacitetete tij akademike.

Stafi akademik i të gjitha njësive bazë në TBU është fokusuar gjithashtu edhe në lidhjen e punës së tij kërkimore - shkencore me procesin mësimor, duke e mbështetur këtë në disa drejtime kryesore të cilat janë:

- Pasurimin e kurikulave lëndore me zhvillimet e fundit të kërkimit shkencor si dhe me raste studimore apo kazuse që ndihmojnë studentët të jenë në lartësinë e duhur me zhvillimet në njohuritë e fushave të ndryshme.

- Mbikqyrjen dhe udhëheqjen e punës kërkimore të studentëve e sidomos të studentëve të programit Master i Shkencave, duke synuar orientimin e tyre drejt çështjeve kërkimore bashkëkohore që kanë lidhje me problematika korente në ekonominë shqiptare apo problematika të bizneseve ku vetë studentët punojnë.
  - Orjentimin e studentëve të cilët janë duke punuar aktualisht pranë bizneseve me njohuri praktike dhe aftësi konceptuale.
  - Orjentimin drejt nevojave konkrete që tregu i punës kërkon sot.
  - Përdorimin e temave të studentëve të programit Master si raste studimore në lëndët përkatëse sipas fushave të studimit, duke i bërë ato edhe objekt diskutimi e rrahje mendimesh midis studentëve.
  - Prezantim dhe diskutim në auditor dhe online të punëve shkencore dhe botimeve që bën pedagogu, për të përcjellë dhe marrë opinionet e studentëve.
  - Përfshirjen nga pedagogët kur është e mundur edhe të studentëve në punët e tyre kërkimore shkencore për të kryer hulumtime, zhvilluar pyetësorë apo të dhëna mbi të cilat bazohet aktiviteti kërkimor-shkencor.
  - Bashkëveprimin e ndërsjelltë (pedagog-student) të dijeve shkencore dhe vënjen në praktikë të tyre.
1. Në lidhje me sa më lart, njësitë bazë në TBU hartojnë në fillim të çdo viti akademik një kalendar të veprimtarisë kërkimore shkencore në të cilin përfshihen aktivitetet e mësipërme, duke specifikuar arritjet dhe çfarë tentohet të realizohet.
  2. **iii) Produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitur në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësia bazë, bashkëpunime nga institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit.**

## **PLANI I PUNES**

### **Nëntor 2021 – Tetor 2022**

Qendra në përgjigje të Pandemisë COVID-19 dhe të të gjitha pasojave të shkaktuara nga ky fenomen, në

bashkëpunim me departamentet e Fakultetit të Ekonomisë dhe të Drejtësisë, planifikon planin e punës në vijim:

Në kuadër të Programit ERASMUS+ - Staff mobility for training between PROGRAMME and PARTNER COUNTRIES dhe të ndërkombëtarizimit të TBU-së janë vendosur kontakte me “Danubius” University – Galati, në Rumani për të aplikuar në këtë program. Gjithashtu, do të vazhdojë implementimi i këtij programi në të njëjtën fushë me Universitetin e Staffordshire pas një ndërprerje si pasojë e pandemisë COVID-19.

Qendra në kuadër të projekteve IPA III do të marrë iniciativë të kontaktojë bashki të ndryshme në jug të vendit, që janë të pranueshme për të marrë pjesë në këto projekte, për të ofruar asistencë në ngritje të start-up-ve ushqimore dhe produkteve të ndryshme autoktone dhe zhvillimit të tyre qoftë nga pikëpamja e cilësisë dhe sigurisë ushqimore (në bashkëpunim me Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë) ashtu edhe në aplikimin për certifikim të produkteve me qëllim eksporti.

Duke parë normalizimin e frekuentimit të procesit mësimor face to face si dhe zhvillimet për një Balkan pa kufij, nga pikëpamja e bashkëpunimit me universitetet të cilat janë në kufi si p.sh Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, marrja e kontakteve për vendosjen e një bashkëpunimi për organizime leksionesh të hapura/Summer School dhe modalitete të tjera shikohet si strategjike qoftë për ndërkombëtarizim ashtu edhe si promovim i të dy institucioneve për të thithur talente dhe për të ofruar mundësi zhvillimi për të rinjtë në rrezen e veprimit të institucioneve respektive.

Në kuadër të eventit **Tirana European Youth Capital 2022**, Qendra ka për qëllim të formojë një grup jo formal studentësh të nivelit master shkencor të TBU-së për të aplikuar në një nga 8 (tetë) temat e përzgjedhura nga Këshilli Rinor Kombëtar. Tema që është më afër profilit të studentëve të TBU-së është “Të Rinjtë Zhvillojnë Kapacitete”- (Investimi në formimin, në arsimimin e të rinjve dhe rritjen e kapaciteteve të tyre – Zhvillim personal dhe Komunikim).

Në kuadër të Programit ERASMUS+ - Staff mobility for training between PROGRAMME and PARTNER COUNTRIES me “Danubius” University – Galati, në Rumani morën pjesë 10 (dhjetë) pedagogë nga departamenti i Ekonomisë dhe Drejtësisë për një periudhë 5 ditore në auditore gjatë muajve Maj dhe Qershor 2022 në dy grupe. Stafi i TBU-së u prit nga Zev. Rektori i Universitetit Dr. Emanuel-Stefan MARINESCU dhe u njoh nga afër me programet e zhvilluara, metodologjinë – leksionet online (ambientet, historikun e themelimit, projektet e zhvilluara dhe ato në zhvillim e sipër). U diskutuan fusha të bashkëpunimit me interes reciprok si p.sh Crossborder Cooperation, pasi Rumania ka një eksperiencë

domethënëse si vend anëtar i BE-së dhe Rajoni i Galati ndodhet pranë kufirit me Moldavinë dhe Ukrainën si dhe përshkohet nga Lumi Danub dhe që është i lundrueshëm. Vazhdimi dhe përshkallëzimi i konfliktit në Ukrainë dhe pasojat ekonomike kanë zbehur pritshmëritë për të vazhduar më tej me një ritëm normal bashkëpunimin.

Në kuadër të projekteve IPA III në lidhje me zhvillimin rural dhe bujqësor, Qendra ka vendosur kontakte me Bashkinë Përmet në personin e Kryetarit të Bashkisë si dhe me Departamentin e Projekteve të BE-së në një vizite në Qytetin e Përmetit gjatë muajit Prill 2022. Motivacioni për të ndërmarrë një iniciative të tillë ka në sfond kërkesën (direktivën) e BE-së për ngritjen e Grupeve Vendore të Veprimit (GVV/LAG) dhe të aprovuar në Parlamentin Shqiptar si Akorë vendorë me status juridik dhe të pranueshëm për të aplikuar në projektet prioritare të qeverisë dhe të fondeve të miratuara nga BE; ekspertiza në terma të ngritjes dhe të funksionimit të këtyre grupeve nga një eksperience e ngjashme në një projekt të BERZH në lidhje me rrugën e re Shëngjin-Velipojë si dhe akses në certifikimin e produkteve bio nga një vend i BE-së dhe konkretisht: Italia. Konsultimet vazhduan edhe online me ekspertë vendas dhe të huaj por Bashkia Përmet kishte problematika me fondet IPA në terma të rimbursimit të TVSH-së dhe të pamjaftueshmërisë së fondeve për të ndërmarrë iniciativa të reja.

Në kuadër të eventit Tirana European Youth Capital 2022 grupi jo-formal i krijuar aplikojë në thirrjen e shpallur nga Bashkia Tiranë me projektin me titull: "Teach, Remember, Inspire, Follow (TRIF)". Projekti parashikonte trajnime për të rinjtë të grupmoshave 18-29 vjec në qytetin e Tiranës, Shëngjinit dhe Kukës gjatë periudhës Prill-Maj-Qershor me një qasje nga sektori i Turizmit dhe Shërbimeve. Projekti i prezantuar nuk rezultojë fitues.

Iniciativa e ndërmarrë në lidhje me bashkëpunimin me Universitetin Ndërkombëtar të Strugën është akoma në proces vlerësimi nga ana e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë. Drafti i Memorandumit është propozuar nga ana e TBU-së.

#### **iv) Të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor.**

Infrastruktura në shërbim të kërkimit shkencor manifestohet në aksesin në EBSCO on-line: burim primar, si një nga libraritë më të pasura e të përditësuara në dispozicion të studentëve dhe të stafit.

Aksesi në EBSCO on-line, mundësohet jo vetëm në bibliotekë dhe në mjediset e tjera të shkollës

por edhe nga distanca përmes website të TBU. Shfrytëzimi i literaturës në EBSCO on-line kryhet jo vetëm në mënyrë fakultative nga studentët por edhe i harmonizuar me kërkesat e programeve studimore nën udhëheqjen e pedagogut.

Burim shumë i rëndësishëm është dhe aktiviteti i Qendrës Kërkimore. Kjo qendër në lidhje me strategjinë e ndërkombëtarizimit të TBU, të studentëve dhe Stafit, në bashkëpunim me Koordinatorin Kombëtar për CEEPUS, ka bërë ndarjen e dy fakulteteve të Administrimit Biznesit dhe Drejtësisë në dy *account* në lidhje me lëvizjen e studentëve dhe të stafit edhe si free movers.

Qendra Kërkimore ka ndërmarrë hapa dhe synon të zhvillojë më tej ato në lidhje me ngritjen e një rrjeti me vendet e Ballkanit Perëndimor me qëllim jo vetëm partneriteti, por për të ndërtuar “struktura” në terma të *working group* për të aplikuar në projekte të ndryshme (mbi bazën e ekspertizës), por edhe për të thithur fonde nga donatorë të ndryshëm rajonal dhe europian.

Tregues të këtij burimi dytësor janë jo vetëm marrëveshjet e nënshkruara, por edhe network-u i ngritur në terma grupi pune kërkimore dhe *know-how* në konceptimin e projekteve, menaxhimin të tyre si dhe aksesit në mbledhjen e të dhënave dhe të menaxhimin të tyre në terma qoftë të përhapjes ashtu dhe të vizibilitetit të dijeve të fituara (parashikohet ngritja e një database). Përfshirja e studentëve në këtë kontekst në terma kërkimor dhe *work experience* përbën atë që TBU e quan zgjatim të “infrastrukturës” njerëzore në funksion të kërkimit shkencor.

Një burim tjetër në infrastrukturën e kërkimit shkencor është abonimi në revistën Business Magazine (në formatin elektronik) si dhe Skan Magazinë. Nga pikëpamja e arkivit TBU ka një arkiv të tezave të mbrojtura nga studentët e nivelit Master shkencor pranë bibliotekës së shkollës. Inkubatori i Biznesit Studentor është një tjetër vecori e infrastrukturës së TBU-së në shërbim të kërkimit shkencor ose të aplikueshmerisë së dijeve të mësuara në auditoret e shkollës. Më shumë se dy sipërmarrje të reja janë ngritur nga studentë që kanë frekuentuar inkubatorin e biznesit të TBU-së.

Në shërbim të kërkimit shkencor janë të gjitha paisjet, si kompjutera, printerat etj, në të gjitha zyrat e stafit akademik, por gjithashtu biblioteka e TBU e cila është e paisur me kompjutera që kanë akses direkt në internet dhe gjithashtu në librarinë elektronike EBSCO. I gjithë stafi dhe studentët e TBU kanë akses falas në internet, nëpërmjet kompjuterave në shkollë por edhe 24/7 në të gjitha ambientet e saj.<sup>2</sup>

**d) Të dhëna mbi programet e studimit:**

*i) IAL-ja informon mbi të gjitha programet e studimit që ofron, përfshirë ato ndërdisiplinore dhe të përbashkëta, nëse ka. Në raport paraqiten programet e studimit që janë aktive, të pezulluara, të mbyllura, për të cilën/cilat është marrë leje për hapjen e tij/tyre, por nuk është aktivizuar.*



---

<sup>2</sup>Me shume për kapacitetet e bibliotekës së TBU, jepet në seksionin B (f).



TBU College është e përbërë nga dy Fakultete, Fakulteti Administrim Biznesi dhe Fakulteti i Drejtësisë. Programet e studimit që ofrohen sipas fakulteteve përkatës janë si më poshtë:

#### **Fakulteti i Administrim Biznesit**

- 1. Programi Bachelor në “Administrim Biznesi” me tre profile; Menaxhim, Kontabilitet -Financë dhe Marketing*
- 2. Programi “Master Profesional” në “Administrim Biznesi i Avancuar” 120 ECTS me tre profile, Menaxhim, E Drejtë Biznesi, Kontabilitet - Financë*
- 3. Programi Master Profesional në “Administrim Biznesi” 60 ECTS me dy profile, Menaxhim, Kontabilitet - Financë*
- 4. Programi Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” 120 ECTS*

#### **Fakulteti i Drejtësisë**


- 1. Programi Bachelor në ‘E Drejtë Biznesi’*
- 2. Programi Master Profesional në “E Drejtë Biznesi” 60 ECTS*
- 3. Programi Master i Shkencave në “E Drejtë Biznesi” 120 ECTS*
- 4. Programi i Integruar i Ciklit të dytë në “Drejtësi” 300 ECTS*

Të gjitha programet e ofruara nga TBU College, të përmendura me lart, janë të licensuara, dhe aktive gjatë vitit akademik 2019-2020. Gjatë këtij viti akademik TBU ka qënë e përfshirë në procesin e riakreditimit për të gjitha programet e studimit që ofron, proces ky i cili përfundoi me sukses.

*ii) IAL-ja informon mbi marrjen e lejes për hapjen e programit të studimit që është në proces vlerësimi, si dhe për programe që ofrojnë formim të vazhdueshëm për të tretë apo për zhvillimin profesional të personelit të tyre. Këto të dhëna shoqërohen me numrin dhe datën e*

*aktit për hapjen, për pezullimin ose për mbylljen e programit të studimit.*

Kjo pikë nuk është relevante për TBU



*iii) IAL-ja pasqyron në raportin vjetor përshatshëmërinë e programeve të studimit me misionin e institucionit, realizimin e synimeve të programit të studimit nga ana e përmbajtjes dhe lidhjen e rëndësishme të programeve të studimit nisur nga vlerësimi i nevojave për aftësi në tregun e punës.*

Synimi i TBU është përgatitja profesionale cilësore e studentëve, përmes harmonizimit të formimit teorik me aftësimin praktik, me përparësi në fushat e administrimit të biznesit, të së drejtës së biznesit, administrimit publik.

Programet e studimit të ofruara nga TBU janë organizuar në mënyrë të tillë që harmonizojnë të gjithë komponentët e tyre, lëndët bazë, lëndët karakterizuese, lëndët me zgjedhje, teorinë me praktikën në perputhje të plotë me misionin e TBU-së. Bashkëpunimi i vazhdueshëm me bizneset dhe zyrat juridike na ndihmon t'i përmirësojmë në vijimësi këto programe.

TBU, e profilizuar në ofrimin e edukimit në fushën e biznesit, ka prioritet të vet ndjekjen e zhvillimeve të reja në ekonominë dhe tregun vendas si dhe atë rajonal e global njëherazi ofertat akademike të IAL-ve shqiptare dhe të huaja. Objektivat e TBU, shprehur në shkallën e punësimit të studentëve apo kuotat e planifikuara për regjistrim, janë bazuar në analizat e thelluara të kryera nga stafi ynë.

Njohja dhe vlerësimi realist i zhvillimeve aktuale dhe me perspektivë në mjedisin rrethues, ndihmohet dhe lehtësohet nga disa faktorë të tjerë siç janë: stafi akademik, që në pjesën më të madhe punon në kompani, banka, zyra profesionale dhe institucione publike; studentët që zhvillojnë praktika të gjata dhe punësohen në kompani, banka dhe institucione të tjera si dhe Alumni tashmë në karrierë; marrëdhëniet e vijueshme bashkëpunimi dhe konsultimi me mbi 120 kompani dhe banka vendase e së fundmi edhe me shkollat të huaja përmes projekteve Erasmus.

Kryerja e një numri të madh aktivitetesh (seminare, leksione të hapura, biseda me personalitete, vizita studimore, projekte të përbashkëta me aktorë të tregut) gjithashtu është një burim të dhënash dhe idesh për njohje me realizëm të zhvillimeve aktuale dhe të perspektivës në shërbim të përshatjes së vazhdueshme të objektivave strategjike dhe operimit të mësimdhënies në TBU

Realizimin e plotë të synimeve të secilit program studimi e tregojnë qartë edhe rezultatet e punësimit të studentëve edhe për vitin akademik 2021-2022.

Rezultatet e punësimit të studentëve sipas cikleve dhe programeve të studimit jepen në seksionin (g) më poshtë.

**e) Ndryshimet në statutin apo rregulloret e IAL-së, si dhe të dhëna për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.**

Njësitë bazë janë të riorganizuara sipas Statutit të ri, ku secili fakultet ka tre departamente, në Fakultetin Administrim Biznesi nga dy departamente lëndore tashmë kemi tre të tillë, ndërsa Qendra Kërkimore tashmë ekziston si njësi bazë, pranë Fakultetit të Drejtësisë dhe emërtimi i ri i saj është “Qendra për Kërkime e Studime Ekonomike dhe Juridike”.

Përpara fillimit të këtij viti akademik, TBU rishikoi të gjitha Rregulloret e programeve të studimit për ti përshtatur ato me kërkesat e VKM Nr.41, datë 24.01.2018 të cilat u miratuan nga Senati Akademik në Qershor 2019. TBU gjithashtu njoftoi MARS, në Tetor për përshtatjen e bërë në rregulloret e programeve në përputhje me VKM nr 41. Rrshikimi kishte lidhje me strukturën e veprimtarive formuese, ku kërkesat e reja janë pasqyruar në strukturën dhe planin mësimor indikativ në Rregulloren e cdo programi studimi.

*Të dhëna për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.*

Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë funksionon në përputhje me Statutin e TBU, rregulloren e “Njësisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë të TBU” dhe Ligjin nr. 80/2015.

NJSBC është një organ i pavarur që krijohet në rang institucioni dhe anëtarët e tij përcaktohen me vendim të Senatit Akademik. Ajo monitoron dhe siguron cilësinë e të gjitha veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore te TBU. Njësia raporton drejtpërdrejtë tek Rektori dhe Senati Akademik. NJSBC përbëhet nga tre anëtarë, ku njëri nga anëtarët është nga Këshillat Studentore.

f) Parashikimin për angazhimin e personelit akademik, ngarkesën përkatëse, lëndën/t, dhe/ose modulën/et që do të zhvillojë secili prej tyre për secilin semestër të vitit akademik.

Në Aneksin 2 jepen të dhënat e personelit akademik, ngarkesat përkatëse dhe lëndët për vitin akademik 2021-2022.

g) Të dhëna për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet përsecilin program studimi që IAL-të ofrojnë, të shoqëruar me burimin e informacionit dhe adresën ku konfirmohet informacioni, duke specifikuar:

*i) përqindjen e punësimit të të diplomuarve, nëse institucioni deklaron se programet e ofruara përgatisin për një karrierë apo profesion të caktuar;*

Procesi i gjurmimit të studentit në TBU menaxhohet nga Zyra e Karrierës dhe Çështjeve Studentore. TBU ruan kontaktet e të diplomuarëve të saj dhe realizon anketime periodike për të gjurmuar ecurinë me punësimin dhe avancimin në karrierë. Të dhënat e anketës përpunohen dhe analizohen nga TBU për të vlerësuar shkallën e punësimit për çdo program studimi dhe në nivel fakulteti, kohëzgjatjen dhe formën e punësimit, shpërndarjen sektoriale, si dhe gadishmërinë e tyre për të vlerësuar mundësi të tjera karriere për të cilat informohen nga Zyra e Karrierës dhe Çështjeve Studentore. Kjo zyrë luan një rol të rëndësishëm për përfshirjen e studentëve dhe të diplomuarëve në aktivitete formuese, kulturore dhe sportive. Në tabelën më poshtë jepen të dhënat për përqindjen e punësimit të studentëve të TBU të diplomuar për vitin 2020-2021:

**Tabela 1 Përqindja e të diplomuarve të punësuar në TBU**

Cikli i Studimit	Fakulteti Administrim Biznesi	Fakulteti i Drejtësisë
Nr. i të diplomuarëve Cikli I-rë	87	19
% e punësimit ne profil, Cikli I-rë	81.6 %	78.9 %
Nr. i të diplomuarëve Cikli II-të	80	17
% e punësimit ne profil-Cikli II-të	97.5 %	88.2 %

Tabela e mësipërme tregon, që përqindja e punësimit në profil të studentëve të diplomuar të TBU-së për vitin akademik 2021-2022 është relativisht e lartë. Përfshirja në një fazë të hershme e studentëve në procese pune dhe praktike, si dhe angazhimi kryesisht në kompani të mëdha dhe të mesme i ndihmoi ata të jenë të qëndrueshëm me punësimin.

Një përqindje e lartë e studentëve bachelor arrijnë të punësohen ende pa përfunduar studimet bachelor, ndërsa ata master të ngjiten një shkallë më lartë në karrierë. Përfshirja e studentit në procese pune dhe praktike në një fazë sa më të hershme ndihmohet nga Zyra e Karrierës dhe Çështjeve Studentore.

Në ciklin e studimeve bachelor në vitin akademik 2021-22; u diplomuan 106 studentë, 19 studentë në E Drejtë Biznesi ku të punësuar rezultojnë 15 prej tyre dhe 87 studentë në Administrim Biznesi ku të punësuar rezultojnë 71 prej tyre. Në ciklin e studimeve master në vitin akademik 2021-22; u diplomuan gjithsej 97 studentë, 17 studentë në E Drejtë Biznesi ku të punësuar rezultojnë 15 prej tyre dhe 80 studentë në Administrim Biznesi ku të punësuar rezultojnë 78 prej tyre.

*ii) Përqindjen e të diplomuarve që kalojnë provimin e shtetit dhe licencohen, kur programi i studimit ka lidhje me një profesion të rregulluar.*

TBU nuk ka raste të tilla studentësh në TBU.

**h) Të dhëna për këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të IAL-së dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.**

Në lidhje me zgjedhjet e këshillave studentore, në përputhje me Ligjin 80/2015, gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2017-2018 u ngrit një grup nismëtar i studentëve, me qëllim realizimin e zgjedhjeve studentore. Zgjedhjet për Këshillat Studentore në TBU, u realizuan në fillim të Vitit Akademik 2018-2019.

Studentët e TBU kanë përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisionin e Marrëdhënieve me Studentët dhe Komisionin e Cilësisë, në nivel institucional dhe nivel fakulteti. Aktiviteti i Këshillave Studentore është zhvilluar

nëpërmjet takimeve dhe mbledhjeve, sipas nevojave. Të gjithë anëtarët e këshillave studentore kanë patur mundësi të shprehin mendimet dhe propozimet e tyre për sfida që lidhen me veprimtarinë mësimore, pagesën e tarifës së shkollimit, dhe organizimin e aktiviteteve sociale.

**i) Vlerësime të IAL-së dhe rekomandime të mundshme për ministrinë, si dhe njëpërshkrim të ndërveprimit të IAL-së me strukturat e varësisë të ministrisë, duke përfshirë edhe:**

*i) Një vlerësim të përgjithshëm të komunikimit me ministrinë dhe institucionet në varësi të saj, duke theksuar mbi përmirësimet e mundshme në këtë komunikim;*

TBU ka patur një bashkëpunim të mirë me ministrinë dhe institucionet në varësi të saj në lidhje me të gjitha çështjet që kanë pasur lidhje me zbatueshmërinë e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Bazuar në Ligjin 80/2015, TBU u shndërrua në Kolegj Universitar dhe aprovimi i Statutit të TBU College në Shtator të vitit 2017 i parapriu vitit akademik 2017-2018. Finalizimi i këtij statuti u bë nëpërmjet një bashkëpunimi të frytshëm midis stafit të TBU dhe strukturave përgjegjëse në ministri (Drejtoria Juridike) për këtë çështje. Gjatë vitit akademik 2017-2018 TBU së bashku me strukturat përgjegjëse në ministri u arrit të finalizohet edhe “Marrëveshja” për përbërjen e stafit akademik me kohë të plotë të njësisë bazë në TBU, e cila u aprovua në 5 Nëntor 2018.

Vlen të theksohet se në të gjitha rastet; ministria dhe strukturat e saj kanë qënë gjithmonë të gatshëm të diskutojnë dhe bashkëpunojnë për të trajtuar të gjitha kërkesat që TBU ka paraqitur në përputhje me detyrimet e ngarkuara nga Ligji 80/2015.

*ii) Vlerësime dhe rekomandime për ndryshime të sistemit apo akteve ligjore e nënligjore në fuqi që ndikojnë në veprimtarinë e IAL-së, të shoqëruar me arsytetime të hollësishme.*

Në lidhje me afatin e dorëzimit nga IAL të Raportit Vjetor vlerësojmë daljen e Udhëzimit Nr 24 datë 21. 10. 2019 të MASR “ Për një ndryshim të Udhëzimit Nr.5, datë 19.2.2018 të MASR “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të Institucioneve të arsimit të lartë”.

**j) Të dhëna mbi studentët si:**

*i) Numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe*

**programeve të studimit;**

Numri i studentëve të rregjistruar dhe atyre të diplomuar në programin e studimit bachelor në Administrim Biznesi dhe Bachelor në E Drejtë Biznesi, për Vitin Akademik 2021-2022, jepen në tabelën më poshtë.

Tabela gjithashtu tregon edhe studentët jo aktiv gjatë këtij viti akademik si edhe studentët të cilët janë çrregjistruar në fund të vitit 2021-2022.

**Tabela 2. Programet e Studimit Bachelor**

Fakulteti Administrim Biznesi "Bachelor" në "Administrim Biznesi"	Nr. Studentëve 2021 -2022	Pezull, Jo aktiv	U diplomuan 2021 -2022	Çrregjistruar në fund të 2021 -2022	Kalojnë në vitin pasardhës 2022 -2023
Viti i Parë (3 profilet)	57	4	0	1	54
Viti i Dytë (3 profilet)	78	5	0	2	64
Viti i tretë "Kontabiliet -Finance"	38	1	30	0	6
Viti i tretë "Menaxhim "	58	7	35	0	23
Viti i tretë "Marketing"	30	2	22	0	8
<b>Numri total Fakulteti Administrim Biznesi</b>	<b>261</b>	<b>19</b>	<b>87</b>	<b>3</b>	<b>155</b>
Viti i tretë "E Drejtë Biznesi"	23	4	19	0	4
<b>Numri total Fakulteti E Drejtë Biznesi</b>	<b>23</b>	<b>4</b>	<b>19</b>	<b>0</b>	<b>4</b>
<b>Totali Bachelor në "TBU"</b>	<b>284</b>	<b>23</b>	<b>106</b>	<b>3</b>	<b>159</b>

Numri i studentëve të rregjistruar dhe atyre të diplomuar në programet e studimit Master në Administrim Biznesi dhe në E Drejtë Biznesi për Vitin Akademik 2021-2022, jepen në tabelën më poshtë.

Tabela gjithashtu tregon edhe studentët jo aktiv gjatë këtij viti akademik si edhe studentët të cilët janë çrregjistruar në fund të vitit 2021-2022.

**Tabela 3. Programet e Studimit Master studentet, te diplomuar , cregjistruar dhe qe kalojne ne vitin pasardhes 21-22**

Fakulteti Administrim Biznesit

Programi i Studimit	Numri i studentëve 2021 - 2022	Pezull, Jo aktivë 2021- 2022	U diplomuan 2021- 2022	Çrregjistruar në fund të vitit 2021- 2022	Kalojnë në vitin pasardhës 2022-2023 (në vijim të studimeve)
I- "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi"					
Viti i parë	11	0	0	0	11
Viti i dytë	32	10	12	0	20



<b>Totali "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi"</b>	<b>43</b>	<b>10</b>	<b>12</b>	<b>0</b>	<b>31</b>
II- "Master Profesional" në "Administrim Biznesi i Avancuar" 120 ECTS (2 -vjeçar) me profile:					
Viti i parë "Menaxhim"	2	1	0	1	1
Viti i dytë "Menaxhim" (te rinj + perserites)	6	3	3	2	1
<b>Totali "Menaxhim" 120 ECTS</b>	<b>8</b>	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>2</b>
Viti i parë "Kontabilitet – Financë"	6	0	0	1	5
Viti i dytë "Kontabilitet – Financë" (te rinj + perserites)	4	1	3	0	1
<b>Totali "Kontabilitet-Financë" 120 ECTS</b>	<b>10</b>	<b>1</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>6</b>
Viti i parë "E Drejtë Biznesi"	5	1	0	1	4
Viti i dytë "E Drejtë Biznesi" (te rinj + perserites)	5	4	4	2	4
<b>Totali "E Drejtë Biznesi"</b>	<b>10</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>8</b>
<b>Totali Master Profesional" në "Administrim Biznesi i Avancuar" 120 ECTS(2-vjeçar) me profile</b>	<b>28</b>	<b>10</b>	<b>10</b>	<b>7</b>	<b>16</b>
III- "Master Profesional" në "Administrim Biznesi" 60 ECTS (1-vjeçar) me profile:					
Viti i parë "Menaxhim"	42	8	27	3	12
Viti i parë (përsëritës që vijnë përtej afatit 1- vjeçar)	9	6	2	0	7
<b>Totali profili "Menaxhim" 60 ECTS</b>	<b>51</b>	<b>14</b>	<b>29</b>	<b>3</b>	<b>19</b>
Viti i parë "Kontabilitet - Financë"	35	6	29	0	6
Viti i parë (përsëritës që vijnë përtej afatit 1- vjeçar)	2	2	0	0	2
<b>Totali profili "Kontabilitet -Financë" 60 ECTS</b>	<b>37</b>	<b>8</b>	<b>29</b>	<b>0</b>	<b>8</b>
<b>Totali "Master Profesional" në "Administrim Biznesi" 60 ECTS (1-vjeçar)</b>	<b>88</b>	<b>22</b>	<b>58</b>	<b>3</b>	<b>27</b>

<b>Totali "Master" në Fakultetin Administrim Biznesi</b>	<b>159</b>	<b>42</b>	<b>80</b>	<b>10</b>	<b>74</b>
--	------------	-----------	-----------	-----------	-----------

**Fakulteti i Drejtësisë**

Viti i parë te rinj MP EDB	19	2	17	2	0
MP EDB ( përsëritës)	3	3	0	3	3
Viti i Parë Program integruar PICD	6	1	0	1	5
Viti i Dytë Program integruar PICD	3	1	0	1	2
<b>Totali Master ne "E Drejte Biznesi", në Fakultetin e Drejtësisë</b>	<b>31</b>	<b>7</b>	<b>17</b>	<b>7</b>	<b>10</b>

<b>Totali Master's në "TBU"</b>	<b>190</b>	<b>49</b>	<b>97</b>	<b>17</b>	<b>84</b>
---------------------------------	------------	-----------	-----------	-----------	-----------

*ii) Numrin e studentëve që ndjekin programe që përbëjnë prioritet kombëtar, të përcaktuar në dokumentin e prioritetëve të miratuar dhe të publikuar çdo vit nga ministria sipas drejtimeve kryesore.*

Programet e studimit të ofruara nga TBU nuk janë programe që përbëjnë prioritet kombëtar

*iii) Numrin e studentëve të shkëlqyer*

Në lidhje me studentët e shkëlqyer gjatë Vitit Akademik 2021-2022, kemi numëruar vetëm studentët me mesataren e ponderuar 10 ose shumë afër notës 10-tës. Në tabelën më poshtë jepen numrat e studentëve të shkëlqyer sipas programeve të studimit dhe vitit të studimit në TBU.

**Tabela 4. Numri i Studentëve të Shkëlqyer**

Studentë të Shkëlqyer, Viti Akademik 2021-2022				
Programi	Viti I	Viti II	Viti III	Master
Bachelor "Adminstrim Biznesi"	0	0	1	0
Bachelor PICD & "E Drejtë Biznesi"	0	0	0	0
MPEDB	0	0	0	1
<b>Total</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>1</b>

*iv) Numri i studentëve të çregjistruar ose të transferuar të shoqëruar me informacion mbi institucionin dhe programin e studimit të parë dhe programin e studimit ku transferohen;*

*Informacioni i detajuar në lidhje me numrin e studentëve të ç'rregjistruar gjatë Vitit Akademik 2021-2022, është dhënë në tabelat e pikës (i) me lartë.*

Për Vitin Akademik 2021-2022 në TBU, tabela e mëposhtme jap studentë që janë transferuar nga IAL të tjera, në Fakultetin Administrim Biznesi, transferimet në programin Master i Shkencave dhe Master Professional.

Në tabelat sipas fakulteteve, më poshtë është dhënë informacioni i detajuar në lidhje me studentët e transferuar në TBU gjatë Vitit Akademik 2020-2021.

**Table 5. Transferimet 2021-2022, Fakulteti Adminstrim Biznesi**

	Viti i Parë në Administrim Biznesi ( 3 profilet)	Viti i Dytë në Administrim Biznesi ( 3 profilet)	Viti i tretë Administrim Biznesi ( 3 profilet)	Master I Shkencave	Master I shkencave program I dyte	Master profesional 60 ECTS	Master profesional 60 ECTS program I dyte 60 ECTS	Master profesional 120 ECTS	Master profesional 120 ECTS program I dyte
Tirana Business University College, "TBU"			2	2	9	7		2	8
Universiteti i Tiranës	1	6	5	3	4		1		1
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës		1	1		1				
Universiteti Politeknik i Tiranës		1					1		
University Of New York Tirana	1		3						
Universiteti Bujqësor i Tiranës	3	1							

Universiteti European i Tiranës			2						
Universiteti "Luarasi"		1							
Kolegji Universitar Insituti Kanadez i Teknologjisë		1							
Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"			1	1	1				
Th -Koln-University of Applied Sciences	1								
<b>TOTALI</b>	6	11	14	6	15	7	2	2	9

Në Fakultetin e Drejtësisë kanë ardhur me transferim gjithsej 8 studentë.

Tabela më poshtë jep edhe shpërndarjen e tyre sipas programeve dhe viteteve.

**Tabela 6. Transferimet 2021-2022, Fakulteti i Drejtësisë**

Institucioni dhe Programi i Studimit të parë	Viti i tretë në e Drejtë Biznesi	Master Profesional
Tirana Business University College, "TBU"	2	3
Universiteti i Tiranës		2
Universiteti "Marlin Barleti"	1	
Total	3	5

**v) Numrin e studentëve që kanë përfituar bursa dhe numrin e atyre që kanë përfituar nga përjashtimi apo reduktimi i tarifave të shkollimit;**

TBU ofron 4 lloje bursash në formën e tarifave të reduktuara në të dyja ciklet e studimit, Bachelor dhe Master, për të (2) dyfakultetet. Llojet e tarifave të reduktuara të studimit janë si më poshtë:

**Tabela 7. Numri i studentëve që kanë përfituar bursa**

Programi/Bursa	Burse ekselence	Burse sociale	Burse konkursi	Burse talenti	Pa burse	Me shume se nje burse	Total
Bachelor I	23	17	2	0	13	6	61

Bachelor II	27	5	1	0	33	3	69
Bachelor III	40	20	0	0	38	13	111
Total	90	42	3	0	84	22	241

\*Bursat e ekselencës për tabelën më lartë klasifikohen ata studentë të cilët kanë mestare në kufirin e notes8 deri 10

Programi/Bursa	Burse ekselence	Burse sociale	Burse promovim institucional	Burse talenti	Pa burse	Me shume se nje burse	Total
Master 60ECTS	35	31	0	0	40	15	121
Master 120ECTS	6	5	0	0	6	2	19
Total	41	36	0	0	46	17	140

Kategorizimi i bursave të ekselencës për studentet e rinj në vitin akademik 2021-2022

Mesatarja e notës së vitit paraardhës	Tarifa për 60 kredite	
	Tarifa Bachelor	Tarifa Master
9.00 e më shumë	150,000	200,000
Për çdo ulje me 0.1 të notës mesatare nga kufiri i mësipërm tarifa rritet me	2,500	2,500

Bursat e ekselencës për studentët në vijim nga 2020-2021 (viti i dytë Bachelor në 2021-2022)

Tarifa e vitit që kontraktohet		
Mesatarja e notës së vitit paraardhës	Tarifa Bachelor	Tarifa Master
9.50 e më shumë	150,000	200,000
Për çdo ulje me 0.1 të notës mesatare nga kufiri i mësipërm tarifa rritet me	2,500	2,500

Bursat e ekselencës për studentët në vijim nga 2019-2020 (viti i tretë Bachelor në 2021-2022)

Tarifa e vitit që kontraktohet		
Mesatarja e notës së vitit paraardhës	Tarifa Bachelor	Tarifa Master
9.50 e më shumë	100,000	200,000
Për çdo ulje me 0.1 të notës mesatare nga kufiri i mësipërm tarifa rritet me	10,000	10,000

**vi) Pjesëmarrja e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre;**

TBU sëbashku me disa universitete të tjera shqiptare dhe Universitetin Staffordshire nga Mbretëria e Bashkuar u bënë fitues për herë të tretë në projektin Erasmus+KA1 (International Credit Mobility project, ICM). Në kuadër të këtij projekti 3 studentë të programit Master i Shkencave në Administrim Biznesi të TBU ndoqën semestrin e parë në Business School, Staffordshire University në vitin 2021-2022.

Gjithashtu studentët gjatë kohës në Staffordshire University, po përdorin edhe burimet e bibliotekave për të punuar temat e tyre të diplomës. Qëllimi i ICM project është pikërisht mobiliteti i studentëve, dhe njohja e tyre me praktikën, metodat dhe kërkesat e mësimdhënies të një universiteti tjetër (në përfundim). Kreditet e fituara në Staffordshire University ju njihen plotësisht si të kryera nga TBU dhe do të jenë pjesë e suplementit të diplomes për studentët.

**vii) Përqindjen e studentëve kalues në vit dhe përqindjen e atyre që diplomohen;**

Duke përdorur të dhënat e paraqitura në tabelat e pikës (i) me lartë janë llogaritur: përqindja e studentëve që kalojnë në vitin pasardhës, përqindja e studentëve të diplomuar dhe përqindja e studentëve të ç'regjistruar, për Vitin Akademik 2021-20212. Në Tabelën me poshtë jepen këto përqindje për programet e studimit bachelor. Nga tabela duket qartë se nga programi i studimit bachelor në Administrim Biznesi nga të tre profilet janë diplomuar mesatarisht 71% e studentëve, ndërsa në programin bachelor E Drejtë Biznesi janë diplomuar 83% e studentëve.

**Tabela 8 Përqindja e studentëve kalues dhe të diplomuar në Programet Bachelor**

	Përqindja atyre që vazhdojnë studimet	Përqindja e të diplomuarve	Përqindja e të çregjistruarve
<b>FAKULTETI ADMINSTRIM BIZNESI</b>			
Viti i Parë Bachelor në Administrim Biznesi (të 3 profilet)	94.73	0	1.75
Viti i Dytë Bachelor në Administrim Biznesi (të 3 profilet)	82.05	0	2.56
Viti i tretë Bachelor Administrim Biznesi "Kontabilitet -Finance"	15.79	79	0
Viti i tretë Bachelor në Administrim Biznesi "Menaxhim "	39.66	60.34	0
Viti i tretë Bachelor në Administrim Biznesi "Marketing"	26.67	73.33	0

FAKULTETI I DREJTËSISE			
Viti i tretë Bachelor në e Drejtë Biznesi	17.39	82.60	0

Në Tabelën më poshtë jepen përqindjet e studentëve që kalojnë në vitin pasardhës, atyre të diplomuar dhe atyre të çregjistruar për programet e studimit master.

**Tabela 9 Përqindja e studentëve kalues dhe të diplomuar në Programet Master**

Programi i Studimit	Përqindja atyre që vazhdojnë studimet	Përqindja e të diplomuarve	Përqindja e të çregjistruarve
Fakulteti Administrim Biznesi			
Viti i parë Master i Shkencave	100	0	0
Viti i dytë Master i Shkencave	62.50	37.50	0
Master Profesional "Administrim Biznesi I Avancuar" 120 ECTS			
Viti i Parë "Menaxhim"	50	0	50
Viti i dytë "Menaxhim" (te rinj +perserites)	16.67	50	33.33
Viti i parë "Kontabilitet – Financë"	83.33	0	16.67
Viti i dytë Kontabilitet – Financë" (te rinj +perserites)	25	75	0
Viti i parë "E Drejtë Biznesi"	80	0	20
Viti i dytë E Drejtë Biznesi" (te rinj +perserites)	80	80	80
Master Profesional "Administrim Biznesi" 60 ECTS			
Menaxhim	28.57	64.29	7.14
"Kontabilitet- Financë"	17.14	82.86	0
Fakulteti i Drejtësisë			
"Master Profesional" në "E Drejtë Biznesi" 60 ECTS			
Viti i parë	0	89.47	10.53

**viii) Një vlerësim të përgjithshëm mbi cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre për secilin cikël dhe program studimi;**


Shkalla e vlerësimit të studentëve të TBU për cilësinë e shërbimeve që iu ofrohet nga shkolla është shumë e lartë. Kjo bëhet prezente nga sondazhet periodike që TBU bën me studentët e vet. Për shkak të këtyre arritjeve dhe përhapjes së opinionit, në radhë të parë nga vetë studentët tanë, shkalla e konkurrimit për tu pranuar në TBU është rritur ndër vite.

Në tabelën më poshtë, jepen mesataret e rezultateve të studentëve gjatë vitit akademik 2021-2022 për çdo cikël dhe program studimi.

**Tabela 10. Mesataret sipas cikleve dhe programeve të studimit, Viti Akademik 2021-2022**

Programet e studimit Viti Akademik 2018-2019	Nr. Studenteve*	Mesatarja e ponderuar per te gjitha lendet
<b>I-"Bachelor" në "Administrim Biznesi"</b>		
Viti Parë	57	7.58
Viti Dytë	78	8.1
Viti Tretë Profili "Menaxhim"	38	8.76
Viti Tretë Profili "Kontabilitet - Financë"	58	7.98
Viti Tretë Profili "Marketing"	30	8.23
<b>Totali: "Bachelor" në "Administrim Biznesi"</b>	<b>261</b>	<b>8.13</b>
<b>II- Fakulteti i Drejtësisë</b>		
Viti Tretë "E Drejtë Biznesi"	23	8.89
<b>Totali: "E Drejtë Biznesi"</b>	<b>23</b>	<b>8.89</b>
<b>I- "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi"</b>		
Viti i parë	11	9.21
Viti i dytë	32	8.29
<b>Totali: MSH "Administrim Biznesi"</b>	<b>43</b>	<b>8.75</b>
<b>II- "Master Profesional" në "Administrim Biznesi i Avancuar" 120 ECTS me profile</b>		
Viti i parë "Menaxhim"	2	9.37
Viti i dytë "Menaxhim" (te rinj +perserites)	6	8.34
Viti i parë "Kontabilitet – Financë"	6	8.75
Viti i dytë "Kontabilitet – Financë" (te rinj +perserites)	4	8.42
Viti i parë te rinj "E Drejtë Biznesi"	5	8.21
Viti i dytë "E Drejtë Biznesi" (te rinj +perserites)	5	8.21
<b>Totali: MP "Administrim Biznesi i Avancuar" 120 ECTS</b>	<b>28</b>	<b>8.55</b>
<b>III- "Master Profesional" në "Administrim Biznesi" 60 ECTS me profile</b>		
Viti i parë te rinj "Menaxhim"	42	9
Viti i parë (përseritës që vijnë përtej afatit 1- vjeçar)	9	8.5
Viti i parë te rinj "Kontabilitet - Financë"	35	8.96
Viti i parë (përseritës që vijnë përtej afatit 1- vjeçar)	2	0
<b>Totali: MP. Administrim Biznesi 60 ECTS</b>	<b>88</b>	<b>8.82</b>
<b>IV- Fakulteti i Drejtësisë</b>		
Viti i parë te rinj MP EDB	19	9.02
MP EDB ( përsertitës)	3	0
Viti i Parë Program integruar PICD	6	8.7
Viti i Dytë Program integruar PICD	3	8.97
<b>Totali: " Fakulteti i Drejtësisë "</b>	<b>31</b>	<b>8.90</b>
<b>Totali TBU</b>	<b>474</b>	<b>8.67</b>

Në përgjithësi gjatë Vitit Akademik 2021-2022 cilësia e studentëve të TBU vlerësohet si shumë e mirë, duke marrë parasysh këtu që janë studentë që studiojnë dhe paralelisht, bëjnë praktika të zgjatura pranë bizneseve gjatë gjithë vitit, ose punojnë me kohë të pjeshme apo të plotë në biznese ku janë të vetëpunësuar.



## **B. Dokumentacioni i përgatitur nga Bordi i Administrimit**





**a) Të dhëna të përgjithshme mbi IAL-në lidhur me strukturën e përgjithshme organizative të institucionit të arsimit të lartë, njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse etj.**

Bazuar në Statutin e TBU College, përbërja strukturore dhe organizative e TBU është si me poshtë:

- a) Pjesa akademike, e cila përbëhet nga organet dhe autoritetet drejtuese akademike, njësitë kryesore (fakultetet) dhe njësitë bazë (departamentet dhe qendrat kërkimore shkencore).
- b) Pjesa administrative, e cila përbehet nga organet dhe autoritetet drejtuese administrative, si dhe njësitë e shërbimit.

Përbërja strukturore dhe organizative e TBU është sipas shtojces 1, që është bashkëlidhur Statutit dhe është pjesë përbërëse e tij.

*Organet dhe Autoritetet Drejtuese Kryesore të TBU*

- *Organi më i lartë drejtues akademik është Senati Akademik.*

Senati Akademik është organi kolegjal më i lartë akademik. Krahas Rektorit, Senati Akademik në përbërjen e tij ka dy anëtarë nga personeli akademik, një për secilin fakultet, si dhe dy studentë, një për secilin fakultet. Për më tepër, flitet në nenin 13 dhe 14 të Statutit të TBU.

- *Autoritetet drejtuese akademike janë: Rektori, Dekani dhe Drejtuesit e departamentit.*

Rektori; është autoriteti më i lartë akademik, si dhe përfaqësues ligjor i TBU, për çështjet akademike dhe protokollare. Për më shumë flitet në nenin 15 të Statutit. Në organikë është parashikuar dhe Zëvendës Rektori, për më shumë flitet në nenin 16 të Statutit.

- *Organe të tjera akademike janë Asambleja e Personelit Akademik dhe komisionet e përhershme. Komisionet e përhershme janë: Komisioni i Cilësisë që ka për detyrë garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit; Komisioni i Marrdhënieve me Studentët që ka për detyrë monitorimin dhe sigurimin e marrdhënieve të përshtatshme të studentëve dhe alumni me TBU.*

- *Organi më i lartë drejtues administrativ është Bordi i Administrimit.*

Bordi i Administrimit (BA) është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e synimit të TBU, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Për më tepër, flitet në nenin 10 të Statutit.

- *Autoritetet drejtuese administrative janë: Administratori i TBU, Administratori i Fakultetit. Administratori i TBU është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të TBU. Për më tepër flitet në nenin 11 të Statutit. Administratori i Fakultetit është përgjegjës për mirëfunksionimin financiar dhe administrativ të fakultetit. Për më tepër flitet në nenin 12 të Statutit.*

- *Organe kolegjiale të tjera janë: Rektorati, Dekanati, Këshilli i Etikës.*

Rektorati është parashikuar në nenin 17 të statutit dhe përbëhet nga: Rektori, Zëvendës- Rektori, Administratori i TBU dhe Dekanët.

*Dekanati është organ kolegjal që drejtohet nga Dekani dhe përbëhet nga: Dekani, Zëvendës Dekani, Administratori i Fakultetit dhe Drejtuesit e Departamenteve. Çdo fakultet ka në organikën e tij: një Zëvendës Dekan. Për më shumë, neni 20 i Statutit.*

*Këshilli i Etikës, promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, si edhe çështjet lidhur me etikën akademike në institucion. Për më shumë, neni 26 i Statutit*

- Dekani është autoriteti më i lartë i Fakultetit dhe përfaqësuesi i tij. Për më shumë flitet në nenin 18 të Statutit. Zëvendësdekani është parashikuar në nenin 19 të Statutit.

- Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe/ose grupon disiplinat mësimore përkatëse. Për më shumë, neni 23 i Statutit.

- *Qendra Kërkimore për Studime Ekonomike dhe Juridike (QKSEJ)* është njësi bazë, që funksionon pranë Fakultetit të Drejtësisë. Për më shumë, neni 25 i Statutit.
- *Drejtuesi i departamentit* është autoriteti drejtues akademik i departamentit dhe e përfaqëson atë. Për më shumë neni 24.
- *Njesia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NSBC)* përbëhet nga tre anëtarë që emërohen drejtpërdrejt nga Senati. Për më shumë, neni 27 i Statutit.

*Njësi të tjera janë Sekretaria Mësimore dhe Zyra e Çështjeve Studentore.* Sekretaria Mësimore, është strukturë administrative në shërbim të procesit mësimor, të protokollimit dhe arkivimit të dokumentacionit. Për më shumë, neni 30 dhe 31 i Statutit. Zyra e Çështjeve Studentore merret me çështjet studentore dhe problemet e veçanta të studentëve. Për më shumë, neni 32 i Statutit.

**b) Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm, planin buxhetor njëvjeçar dhe planin strategjik të zhvillimit të institucionit**

TBU operon me plane buxhetore afatmesme indikative 3 vjecare, me plan buxhetor 1 vjecar. Gjithashtu, Strategjia e Zhvillimit (2018-24) dhe Strategjia Për Kërkimin Shkencor (2018-24), të dyja për periudhën 6-vjecare, mbështeten në disa të dhëna të përgjithshme financiare 6 vjecare. Plani buxhetor afatmesëm përgatitet çdo vit duke bërë parashikimet e tre viteve akademike pasrendëse.

Procesi për përgatitjen e buxhetit 3 vjecar akademik 2019-22 filloi që në Shkurt 2019 me përcaktimin e kuotave të pranimit dhe tarifave të pranimit si dhe të volumit të punës akademike (mësimore dhe kërkimore) të pritëshme bazuar në programet/profilet, lëndët, dhe proceset e tjera të lidhura me procesin mësimor dhe atë të kërkimit shkencor edhe për vitin akademik 2021-2022.

Sipas planit strategjik të zhvillimit, TBU do të vijonte rritjen numerike drejt plotësisimit të kapaciteve në vitin 2018-19 (rreth 500 studentë aktivë të kontraktuar) ndërsa tre vitet e tjera do të jenë vite të konsolidimit strukturor dhe financiar.

Krahas rritjes numerike prioritet kryesor për vitin 2021-22 ishte përcaktuar edhe rritja e cilësisë

së studentëve të pranuar në TBU përmes rritjes së numrit të aplikantëve për kuotë, pra atë të forcimit të konkurrencës në hyrje.

Nga ana e shpenzimeve faktorët ndikues sipas strategjisë së zhvillimit do të ishin plotësimi i strukturave akademike sipas ligjit 80/2015, përfshirja në kërkim shkencor institucional si dhe pastrimi i llogarive nga të ardhurat nga studentët që kishin braktisur studimet apo zvarritur ato përtej kufijve ligjore dhe nuk kishin plotësuar detyrimet kontraktore për pagesën e studimeve.

Në tërësinë e tij plani buxhetor afatmesëm parashikonte arritjen e vetëfinancimit të mjaftueshëm të TBU nga tarifat e shkollimit brenda vitit akademik 2018-19, por duke patur një farë subvencionimi të fakultetit të Drejtësisë nga diferenca e të ardhurave nga Fakulteti Administrim Biznesi ndërsa në vitin akademik 2019-20 të arrihej edhe vetëfinancimi i Fakultetit të Drejtësisë.

Per vitin akademik 2021-22 nuk u modifikuan tarifat e studimit për Bachelor/Master. Gjithashtu kriteret për diferencim tarife për shkaqe ekonomike e sociale janë të njëjta. TBU ka vijuar e do të vijojë të mos aplikojë tarifa dytësore për vërtetime apo për riprovime.

**c) Realizimin faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor sipas zërave të buxhetit, planin buxhetor të vitit pasardhës akademik, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik në vijim.**

Shpenzimet totale për vitin akademik 2021-22, për veprimtarinë e drejtpërdrejtë akademike kapen shifrën prej rreth 58,7 milion lekë nga të cilat rreth 51,9 milion i takonin shpenzimeve për personelin dhe pjesa tjetër shpenzimeve të tjera operative, përfshirë fondin e amortizimit, me një vlerë prej rreth 1,8 milion lekë (vlera e të cilit ka ardhur në rritje për shkak të instalimeve kompjuterike, hardware dhe software, pajisje zyre dhe rikonstruksione zyrash).

Nga ky buxhet përlllogaritet se rreth 25% destinohet direkt apo indirekt për kërkim shkencor, duke konsideruar këtu orët për kërkim shkencor të pedagogëve me kohë të plotë, shpenzimet për abonimin në bibliotekën elektronike ndërkombëtare EBSCO on-line, abonime në literaturë, organizime konferencash, pjesmarrje në projekte Erasmus, konferenca, fuqizim të bazës kompjuterike etj.

Shitjet neto nga tarifat e studimit arritën shifrën prej 59,5 milion lekë, vihet re një ulje e konsiderueshme nga ajo e një viti më parë, por ajo që duhet theksuar është se një ulje të ndjeshme kanë pësuar dhe shpenzimet. Kjo ka ndikuar që rezultati financiar 2021-22 në krahasim me atë të një viti më parë, të jetë më i mirë (edhe pse me një diferencë të vogël).

Duhet theksuar se ngjarjet si: termeti i Nentorit 2019, dhe ne vecanti pandemia Covid-19 goditen fort buxhetet individuale dhe familjare të studenteve të TBU, pasi pjesa më e madhe e tyre jetojnë me pagat e punësimit dhe mbyllja e aktiviteteve ekonomike drejtpërdrejt apo indirekt shkaktoje një periudhë papunësie për shumë nga studentet tane. Vështiresite ekonomike të studenteve u transmetuan në financat e TBU (dhe vazhdojnë të ndihen ende) në formën e vonësës së pagesave të kesteve, të rritjes së kërkesës për shtese burse sociale në formën e zbritjeve, pjesa më e madhe e të cilave janë miratuar, si dhe në formën e cregjistrimit.

Rezultati financiar si diferencë e të ardhurave me shpenzimet për vitin akademik mbeti modeste në rëndinë e 0.48 milion lek, e cila do të destinohet në radhë të parë si fond për zhvillim në vitet e ardhshme.

**d) Dokumentacionin e shlyerjes së detyrimeve tatimore, si dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore;**

Dokumentacioni i shlyerjes së detyrimeve tatimore si dhe dokumentacioni për shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ndodhen në Aneksin 3.

**e) Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik të financuara nga IAL-ja apo të realizuara në kuadër të projekteve ndërkombëtare.**

TBU sëbashku me disa universitete të tjera shqiptare dhe Universitetin Staffordshire nga Mbretëria e Bashkuar u bënë fitues për të tretin vit radhazi, në projektin Erasmus+KA1, me numër reference Erasmus+KA1 Project2018-1-UK01-KA107-046977. Ky projekt është fituar për vitin 2020-2021, por për shkak të situatës së vështirë të pandemisë dhe masave shtrënguese të tyre, projekt u implementua në vitin akademik 2021-22.

**f) Të dhëna për plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore, në**

**përputhje me Kodin e Cilësisë, ku përfshihen ndryshime në mjediset didaktike, kërkimore, politika të shpërndarjes së fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë, numri i teksteve dhe infrastruktura informatike në funksion të mësimin, në bashkëpunim me Senatin Akademik të institucionit të arsimit të lartë.**

Në lidhje me plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore nga TBU për Vitin Akademik 2021-2022, janë kryer inspektimet nga grupi i punës i dërguar nga MASR. Grupi i punës pasi bëri inspektimin nga afër të kapaciteteve pritëse të TBU, ka dërguar edhe raportin i konfirmon plotësimin e kriterëve për kapacitetet pritëse sipas legjislacionit në fuqi.

